




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	165/15
Nr. i fq. / Br. st	- 6 -
Data: / Datum	30.07.2015
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), dhe nenit 17 shkronja @, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L – 145, për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe të dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 10/2010, nenit 41.2 pika (c) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrië në mbledhjen e mbajtur **30 korrik 2015**, aprovoi këtë:

RREGULLORE

PËR FUQIZIMIN DHE PROMOVIMIN E VULLNETARIZMIT

NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit, i marrëdhënieve që krijohen midis vullnetarëve dhe subjektit juridik, organizatorë të vullnetarizmit për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në komunë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton punën vullnetare të rinjve në komunë, ku terminologjia bazë e punës vullnetare, principet dhe termat rregullohen si të drejta dhe obligime të vullnetarëve dhe të subjekteve organizatore të vullnetarizmit, kushtet për formulimin e kontratave të vullnetarizmit dhe kodeve etike, lëshimin e certifikatave të vullnetarizmit, vlerësimin me çmim për vullnetarizmin dhe garantimin e zbatimit të kësaj rregulloreje;
2. Kjo rregullore trajton të gjitha llojet e marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe subjekteve organizatore të vullnetarizmit, gjatë kryerjes së aktiviteteve jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë;
3. Kjo rregullore zbatohet tek shërbimet dhe aktivitetet komunale, realizimi i të cilave organizohet në bazë të kësaj rregulloreje.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë rregullore përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) “**Vullnetar/e**” – nënkupton nocionin që është përcaktuar në ligj dhe udhëzim administrativ, gjegjësisht është një individ, i cili investon kohë, përpjekje, njohuri apo aftësi vetjake me vullnetin e tij të lirë, në shërbim të aktiviteteve dhe veprimtarive të kryera me qëllim mirëqenien e një individi tjetër apo të publikut të gjerë, që zhvillohen sipas mënyrës që parashihet kjo rregullore, pa kërkuar në shkëmbim asnjë formë shpërblimi financiar apo material për vullnetarizmin e kryer. Vullnetar mund të jetë secili individ që zotëron një aftësi për punë dhe kryen punë vullnetare në komunë;
- b) “**Vullnetar minoren**” - vullnetar i ri, nën moshën 16 vjeç, i cili kryen punë vullnetare; në komunë;
- c) “**Kontratë vullnetarizmi**” – kontratë e lidhur me vullnet të lirë, midis subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, për zhvillimin e aktiviteteve apo veprimtarive jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë;
- d) “**Mentor**” – është individi lider, i cili e bën monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve;
- dh) Përveç përkufizimeve të përcaktuara me këtë rregullore, do të përdoren edhe përkufizimet e cekura në Udhëzimin administrativ për punën vullnetare të të rinjve.

Neni 4 Përfitimet e komunës nga puna vullnetare

- 1. Nxiti qytetarin aktiv;
- 2. Ndhmon komunën në realizimin e projekteve në interes publik;
- 3. Promovon dhe fuqizon vlerat e të rinjve në komunë;
- 4. Përmirëson mirëqenien e qytetarëve;
- 5. Forcon bashkëpunimin dhe besimin në mes të qytetarëve dhe komunës;
- 6. Ndhmon komunën në realizimin e interesave të tjera për komunën;
- 7. Ndhmon komunën në afirmimin e saj në procesin e integritetit, dhe
- 8. Ndhmon integritetin e të rinjve brenda komuniteteve.

Neni 5 Promovimi

- 1. Vullnetarizmi njihet dhe promovohet si një aktivitet i një interesi të veçantë për komunën, për aq sa përmirëson cilësinë e jetës, stimulon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore dhe kontribuon në zhvillimin e një shoqërie të barabartë, humane dhe demokratike;
- 2. Roli i vullnetarizmit dhe rëndësia e tij duhet të përcillen tek fëmijët dhe të rinjtë, nëpërmjet aktiviteteve jashtarsimore në shkollimin e ulët dhe të mesëm. Kjo duhet të përcillet me aktivitet praktik, duke i angazhuar nxënësit në punë të dobishme shoqërore.

Neni 6

Aktivitetet që nuk trajtohen si punë vullnetare

Sipas kësaj rregulloreje, aktivitetet e poshtëshënuara nuk konsiderohen vullnetarizëm:

- a) Kryerja e aktiviteteve vullnetare ose ofrimi i shërbimeve që nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet tjera nënligjore;
- b) Zhvillimi i aktiviteteve ose ofrimi i shërbimeve kundrejt përfitimit financiar apo material të parregulluar me kontrata të rregullta sipas Ligjit të punës;
- c) Kryerja e punëve pa shpërblim, natyra e së cilave i përket një marrëdhënieje punësimiti, e cila rregullohet me Ligjin e punës;
- d) Kryerja e punëve ose ofrimi i shërbimeve që njëra palë është e detyruar të kryejë për palë të treta, siç përcaktohet me ligj apo akte nënligjore;
- e) Përmbushja e detyrimeve dhe kryerja e aktiviteteve që një individ është i obliguar të zhvillojë për një palë të tretë të përcaktuar me ligj apo rregullore tjera;
- f) Zbatimi i detyrimeve të veçanta në përputhje me vendim gjyqate;
- g) Kryerja e veprimtarive ose shërbimeve që janë për përfitim të rrethit familjar apo miqësore;
- gj) Aktivitetet lidhur me punët vullnetare që i zhvillojnë partitë politike, nuk trajtohen me këtë rregullore.

Neni 7

Puna vullnetare në komunë bëhet për interes publik.

Neni 8

Trajtimi i vullnetarëve

1. Organizatori i punës vullnetare në komunë është i detyruar t'i trajtojë vullnetarët në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, bindjeve politike apo besimit, përkatësisë nacionale apo sociale, gjendjes financiare, arsimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësive familjare apo anëtarësimit ose mos anëtarësimit në një parti, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve;
2. Librezat për vullnetarë të ndahen në tri kategori: 1.Lider, 2. Aktivist, 3. Pjesëmarrës.

Neni 9

Zyrtari komunal për rini dhe mentori

Zyrtari komunal për rini është përgjegjës që:

- a) Të mbajë regjistrin e vullnetarëve, të pranuar nga organizatori i punës vullnetare;
- b) Të përcjellë regjistrat e vullnetarëve në nivel qendror – Departamentin e Rinisë;
- c) Të pranojë kërkesat nga organizuesit e punës vullnetare për pajisje me librezë vullnetare;
- d) Të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin tjetër përkatës dhe vendos për lëshimin e librezave për secilin vullnetar të paraqitur;
- e) Të përcjellë ndryshimet eventuale në statusin dhe marrëveshjen e vullnetarit, si dhe të kujdeset që këto ndryshime të jenë në pajtim me këtë rregullore;
- f) Të bëjë vërtetimin e librezave, duke i vulosur;
- g) Të kryej edhe punë të tjera që lidhen me aktivitetin e punës vullnetare në komunë, e që nuk bien ndesh me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 10

Përgjegjësit e Mentorit

Mentori është përgjegjës për:

- a) Koordinimin e punëve, bashkë me vullnetarin - vullnetarët;
- b) Përcaktimin e objektivave të aktivitetit për zhvillimin e punës vullnetare;
- c) Monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve;
- d) Hartimin e raportit për zhvillimin e punës nga ana e vullnetarit, ku përfshihen orët vullnetare të mbajtura, sfidat gjatë kryerjes së punës vullnetare, trajnimet që janë propozuar në mes vullnetarit dhe mentorit, efektet e arritura, të cilat do të maten nga performanca në punë dhe aftësitë e veçanta që janë treguar nga vullnetari;
- e) Kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 11

1. Kriteret dhe kushtet që duhet t'i plotësojë një mentor, duhet t'i caktojë organizuesi i punës vullnetare;
2. Mentori duhet të ketë vlera morale dhe përvojë relevante.

Neni 12

Obligimet e vullnetarëve

Obligimet e vullnetarëve janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.

Neni 13
Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare

Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare bëhet në pajtim me udhëzim administrativ.

Neni 14
Njohja e punës vullnetare

T'ju njihet puna vullnetare e atyre që punuan vullnetarisht edhe për vitet e mëhershme, gjegjësisht nga viti 2008 e tutje.

Neni 15
Motivimi i vullnetarëve

1. Përparësi në përfitimin e bursave
2. Përparësi në pjesëmarrje në trajnime;
3. Ndarja e shpërblimeve për punën vullnetare;
4. Promovimi i rezultateve nga puna vullnetare në mjetet publike për publikim (ueb-faqe, gazeta, revista, fletëpalosje etj.);
5. Organizimi i aktiviteteve kulturore për vullnetarë;
6. Përfshirja e vullnetarëve në organizimin e aktiviteteve kulturore të organizuara nga komuna;
7. Shfrytëzimi i objekteve publike për aktivitetet e organizatave vullnetare;
8. Ofrimi i mundësive për kryerjen e punës praktike në institucionet publike - administratë komunale;
9. Organizimi i fushatës promovuese të vullnetarizmit.

Neni 16
Integrimi i punës vullnetare brenda planit të veprimit

Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjesë e Planit të punës, Planit të veprimit dhe çdo dokumenti tjetër të drejtorisë përgjegjëse për rini.

Neni 17
Vullnetarizmi brenda KVRL-së

Vullnetarizmi brenda Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) dhe qendrave rinore. Aktivitetet e kryera, ose shërbimet e ofruara nga KVRL dhe qendrat rinore që veprojnë brenda komunës, parim kryesor do ta kenë punën vullnetare, përmes së cilës bëjnë ngritjen e vetëdijes për punë vullnetare të anëtarëve të saj.

Neni 18
Baza e të dhënave

Zyrtari rinor i ndihmuar nga KVRL dhe Qendra rinore, ka obligim që të mbajë bazën e të dhënave, me qëllim të monitorimit të punës vullnetare.

Neni 19
Buxheti

Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore komunale.

Neni 20
Puna vullnetare gjatë procesit mësimor

Nxënësit nuk mund t'i përcjellin aktivitetet e punës vullnetare gjatë procesit mësimor.

Neni 21
Zbatimi



Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe drejtoria kompetente për rini.

DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE
Neni 22

Aspektet e vullnetarizmit të rregulluara me këtë rregullore, si dhe marrëdhëniet që lindin nga kontrata e vullnetarizmit që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, janë objekt i dispozitave të përgjithshme ligjore

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit të saj në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova